

Јавна установа  
Institucioni publik  
ДЕТСКИ КУЛТУРЕН ЦЕНТАР КАРПОШ  
QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË KARPOSH  
Скопје, Република Северна Македонија  
Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut



Број/numër 08-112/2

Дата/data 21.02.2023

**RAPORT PËR AKTIVITETET PROGRAMORE  
TË IP "QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË" –  
KARPOSH**

**SHKUP, 2023**

## HYRJE

Qendra Kulturore për Fëmijë - Karposh është një institucion me renome i qytetit, me një traditë prej më shumë se shtatë dekadash.

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh realizon programe kreative, moderne dhe ndërvepruese, seksione dhe punëtori që ndjekin dukuritë dhe trendët socialë, në përputhje me interesat e fëmijëve dhe të rinjve. “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh gjatë ekzistencës së saj ruan gjithçka që është e mirë dhe e plotëson me metoda moderne pune, duke ndjekur nevojat dhe dëshirat e përdoruesve.

E orientuar drejt hulumtimit dhe zbulimit të potencialit dhe talenteve të fëmijëve dhe të rinjve në të gjitha fushat e kulturës, “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh synon komunikim të drejtpërdrejtë me fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet aktiviteteve dhe seksioneve të saj, duke i orientuar drejt nevojës për përvojë artistike, njohuri dhe argëtim.

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh përdor edukimin, rrjetëzimin, decentralizimin e aktiviteteve si instrumente kyçe, krijon njohuri dhe produkte të veprimtarisë artistike, bart njohuritë nga mjediset e tjera në mjedisin ku punon dhe është e hapur ndaj zgjidhjeve të reja dhe fushave të reja kulturore dhe artistike. “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh është institucion referues në fushën e bashkëpunimit kulturor ndërkombëtar në fushën e artit dhe kulturës për fëmijë dhe është organizator dhe realizues i disa manifestimeve ndërkombëtare për fëmijë dhe të rinj në vendin tonë.

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh i orienton aktivitetet e saj në radhë të parë drejt grupit të synuar, fëmijëve dhe të rinjve, si përfitues të drejtpërdrejtë potencialë, pastaj prindërve të tyre dhe pjesëmarrësve të tjerë në zhvillimin e nevojave kulturore, bashkëpunëtorëve profesionistë në fushën e kulturës dhe edukimit të fëmijëve dhe të rinjve.


Drejtor

Dr. Biljana Lalçevska Serafimovska



# KARTA E IDENTITETIT “QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË” - KARPOSH

## Lokacioni



## Informata bazë

Adresa: bul. “Ilinden” numër 53, 1000 Shkup

## RESURSE MATERIALO-TEKNIKE

- Qendra përbëhet nga dy kate dhe bodrum me sipërfaqe të përgjithshme të godinës prej 540 m<sup>2</sup>
- Oborri është me sipërfaqe rreth 490 m<sup>2</sup> me hortikulturë të rregulluar.
- **Numri i përgjithshëm i ambienteve në qendër: 11**

Zyra: 5

1. Salla për aktivitete performuese 2
2. Laborator eksperimental 1
3. Ambient për aktivitete muzikore 2
4. Ambient për aktivitetet e arteve pamore 1

## MISIONI

Pozicionimi në shoqëri i aktiviteteve kulturore - edukative për fëmijë dhe të rinj, nëpërmjet inovacionit dhe ndjekjes së trendëve modernë në kulturë dhe zhvillimit personal të fëmijët dhe të rinjtë.

## VIZIONI

Fuqizimi i pozicionit në krye të strukturës piramidale në sistemin e institucioneve që merren me kulturën për fëmijë dhe të rinj, i cili do të japë sistematikisht kontribut konkret në zhvillimin e krijimtarisë dhe do të vendosë standarde në zhvillimin e personalitetit krijues, inovativ dhe gjithëpërfshirës të fëmijët dhe të rinjtë.

## MOTOJA

Koha e lirë e fëmijëve e kaluar në mënyrë cilësore është themeli  
i së ardhmes sonë më të mirë!..

**BËHU PJESË E JONA!**

## PARIME

Në realizimin e veprimtarisë e cila është me interes publik, respektohen parimet e mëposhtme:

- ✓ siguria e dhënies së shërbimeve,
- ✓ vazhdimësia dhe cilësia e shërbimit,
- ✓ transparenca, qasja dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimeve,



Më shumë se 70-vjet krijimtari fëmijërore ka qenë dhe do të jetë edhe në të ardhmen sinonim i punës së QKF -Karposh. Deviza e deritanishme ishte dhe mbetet të jemi vazhdimisht të pranishëm dhe qendër aktuale e fëmijëve dhe të rinjve në Shkup dhe me gjerë. Dritarja jonë magjike drejt së ardhmes është veprimtari e zgjeruar dhe plotësim i punës së deritanishme dhe aktiviteteve të ndryshme me të gjitha atributet e rinisë e cila ka karakter eruptiv. “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh integron fëmijët e moshës parashkollore deri në moshën 17 vjeçare në aktivitetet e Qendrës, dhe nëpërmjet saj i integron në jetën shoqërore të qytetit dhe vendit, mundëson integrim të adaptuar didaktik të fëmijëve në jetën kulturore-shoqërore. Zhvillimi individual i fëmijëve është orientuar drejt realizimit të stabilitetit afatgjatë shoqëror dhe sigurisë, nëpërmjet aktiviteteve kreative, pedagogjike, argëtuese dhe rekreative.

Baza e Qendrës përbëhet nga anëtarësimi masiv i fëmijëve në të dhe përmbajtjet e shumëllojshme të cilat i ofron dhe siguron me gatishmëri dhe vazhdueshme për t'i plotësuar dhe ndryshuar ato në raport me nevojat dhe interesat e fëmijëve. Me këtë imponohet domosdoshmëria e krijimit të një fizionomie të njohur dhe të qëndrueshme të Qendrës në të gjitha nivelet e jetës shoqërore me qëllim që të shndërrohet në një bashkësi funksionale të fëmijëve dhe lidhjeje ndërmjet tyre dhe shoqërisë. Me këtë mundësohet qasje e thjeshtë dhe e shpejtë e fëmijëve në të gjitha sferat me interes për ta, por edhe anasjelltas, hapet mundësia për pjesëmarrje aktive në të gjitha strukturat shoqërore në Qendër.

Nga ana tjetër Qendra miraton dhe zhvillon përmbajtje dhe forma bashkëkohore edukativo-pedagogjike nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit dhe ndjekjes së trendëve ekzistues në fushat me interes. Kështu Qendra merr dimensionin e edukatorit afatgjatë kulturor-shoqëror për fëmijët.

Qendra përcakton vlerat në shoqëri nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me organizata me karakter të ngjashëm, OJQ-të dhe subjekte ekonomike dhe i aplikon në mënyrë didaktike në punën e saj të përditshme.

Detyrat më specifike janë zgjerimi i aktiviteteve të Qendrës në drejtim të standardeve evropiane me konceptim dhe performancë të projektuar.

Për aktivitetet e Qendrës nga këndvështrimi i prezantimit të saj në qytet, brenda dhe jashtë vendit, do të shfrytëzohet çdo event në nivel komunal, qyteti dhe shtetëror ku ka mundësi për afirmimin dhe popullarizimin e saj. Me përmbledhjen e të gjitha aktiviteteve cilësore të shkollave në qytet, Qendra ka funksionin e prizmit nëpërmjet të cilit kryhet një lloj prerjeje tërthore e shkallës së zhvillimit kulturor-shoqëror të fëmijëve në shkollë.

Gjithashtu, me rëndësi thelbësore është pjesëmarrja e vazhdueshme sistematike dhe profesionale e “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh në të gjitha mediumet si formë e prezantimit të Qendrës, ashtu edhe me

aktiviteteve e veta, dhe akoma më me rëndësi për të është krijimi dhe zbatimi i strategjisë për tërheqjen e donatorëve, sponsorëve, vullnetarëve dhe përkrahësve të “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh.

Aktivitetet e përgjithshme të “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh shprehen nëpërmjet seksioneve të mëposhtme:

SEKSIONE	PUNËTORI
SEKSIONI FOLKLORIK	KATI ETNO-KREATIV
SEKSIONI I BALETIT	
SEKSIONI I PIKTURËS	
SEKSIONI PËR MËSIMIN E KITARËS KLASIKE	
SEKSIONI PËR MËSIMIN E DAULLES, GAJDES...	
SEKSIONI I PING – PONGUT	
SEKSIONI I KORIT	
SEKSIONI I SHAHUT	
SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE	

Përveç mbajtjes së seksioneve, “Qendra Kulturore për Fëmijë” – Karposh realizon edhe manifestime të brendshme dhe të jashtme:

MANIFESTIME TË BRENDSHME TË ORGANIZUARA DHE REALIZUARA NGA QKF - KARPOSH	MANIFESTIME TË JASHTME TË MBËSHTETURA NGA QYTETI I SHKUPIT
Kërcej dhe këndoj për nënën time	Festivali ndërkombëtar për kitarë klasike “Temolo”
Ndërtoj qytetin tim	Alfabeti ZOO 4
Koncert në vigjiljen e Vitit të Ri – ORË PUBLIKE – seksioni i baletit	Zhvillojmë dhe ndërtojmë talente të reja (punëtori)
Vizatin në asfalt	Valle pa kufi
Kuizi i nxënësve	Instrumentet e të parëve të mi
Foto-konkursi – Kafsha ime shtëpiake	Festivali i baletit klasik dhe vallëzimit modern
Pjesëmarrje me seksionin folklorik	Festivali i krijimtarisë fëmijërore –

	TRAMBOLINI
Dita e shëndetit – Kros	Punëtori për mentorim krijues
Shfaqje e korit të fëmijëve të qytetit „Zëri i Fëmijëve të Shkupit” në eveniment vjetor në SOS “Fshati i fëmijëve”	Maratona e leximit
Konkursi i pikturës me rastin e 1 Prillit	Koristët gazmorë
Projekti - luajmë së bashku	Pjesëmarrje në manifestime ndërkombëtare
Shkolla verore për gjuhën turke së bashku me Yunus Emre Enstitüsü	
Nata e Bardhë	
Koncert në kitarë klasike i Georgi Trajkovit	
Turne në ping-pong dhe shah	
Lëviz për shëndetin	
Punëtori edukative për trashëgiminë kulturore	
Punëtori etno-kreative	
Ekspozitë - Filip Ciglenjak Simonovski	
Foto konkursi – Kafsha ime shtëpiake	

Në tekstin e mëposhtëm, mbështetur me tekst dhe fotografi, është prezantuar puna e QKF - KARPOSH për vitin 2022.

## **I. MANIFESTIME, PROJEKTE DHE EKSPONATA TË FINANCUARA NGA QYTETI I SHKUPIT**

1. Zhvillojmë dhe ndërtojmë talente të reja (punëtori)
2. Punëtori për mentorim krijues
3. Maratona e leximit
4. Koristët gazmorë me korin e fëmijëve të qytetit „Zëri i Fëmijëve të Shkupit“
5. Festivali ndërkombëtar i kitarës klasike - TREMOLO
6. Instrumentet e të parëve të mi
7. Alfabeti ZOO - 4
8. Festivali i baletit klasik dhe vallëzimit modern
9. Festivali i krijimtarisë fëmijërore -TRAMBOLINI
10. Valle pa kufi
11. Pjesëmarrje në manifestime ndërkombëtare – Pjesëmarrje e seksionit folklorik pranë IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” Karposh në Kushadasi, Republika e Turqisë.

## **II. MANIFESTIME TË BRENDSHME, PROJEKTE DHE EKSPOZITA TË QKF - KARPOSH**

1. Kërcej dhe këndoj për nënën time
2. Shfaqje e korit të fëmijëve të qytetit „Zëri i fëmijëve të Shkupit” në manifestimin vjetor në SOS “Fshati i Fëmijëve”
3. Kuizi i nxënësve - 2022/2023
4. Konkurs i pikturës me rastin e 1 prillit
5. Dita e shëndetit – Kros
6. Vizatime në asfalt
7. Shkolla verore për gjuhë turke së bashku me Qendrën kulturore turke Junus Emre
8. Pjesëmarrje në manifestim humanitar – Luajmë së bashku
9. Pjesëmarrje në „Nata e Bardhë“
10. Koncert në kitarë klasike i Georgi Trajkovit
11. Turne në ping-pong dhe shah
12. Lëviz për shëndetin
13. Ndërtoj qytetin tim
14. Punëtori edukative për trashëgiminë kulturore
15. Këndi etno-kreativ
16. Ekspozitë - Filip Ciglenjak Simonovski



17. Foto konkursi – Kafsha ime shtëpiake

18. Orë publike në vigjilje të Vitit të Ri – prezantim i seksionit të QKF „Karposh“

### **III. INVESTIME KAPITALE NGA QYTETI I SHKUPIT**

1. Përgatitja e projektit themelor për riparim dhe rikonstruksion
2. Riparimi dhe rikonstruksioni i bodrumit dhe katit të objektit

### **IV. PASQYRA STATISTIKORE E NXËNËSVE**

### **V. RAPORTI FINANCIAR**

# I. MANIFESTIME, PROJEKTE TË FINANCUARA NGA QYTETI I SHKUPIT

## 1. Zhvillojmë dhe krijojmë talente të reja

Për herë të katërt, me një kohëzgjatje prej një muaji nga fillimi i marsit deri në fund të prillit, u zbatua me sukses projekti "Zhvillojmë dhe ndërtojmë talente të rinj". Ky projekt përmban një sërë punëtorish nga krijimtaria popullore maqedonase në të cilat morën pjesë fëmijë nga shkollat fillore dhe kopshtet e qytetit të Shkupit.

QKF-Karposh me këtë projekt, të cilin e përkrah Qyteti i Shkupit, inkurajon fëmijët që nga mosha e hershme të zbulojnë talentin dhe dashurinë e tyre për artin etnik, përkatësisht për krijimtarinë popullore maqedonase.

Këtë vit projekti përveç faktit që përfshiu fëmijët e kopshteve dhe shkollave fillore, ka dhënë mundësinë e pjesëmarrjes përmes regjistrimit elektronik për fëmijët nga mosha 6 deri në 11 vjeç. Fëmijët patën mundësinë të regjistrohen në punëtoritë që u mbajtën edhe në ambientet e QKF- Karposh.

Fëmijët e sotëm që në moshë më të hershme shihen si jashtëzakonisht të avancuar dhe shfaqin aftësi me të cilat dinë të na surprizojnë dhe befasojnë.

Në 15 punëtori, 174 fëmijë treguan potencialin, aftësitë dhe dashurinë e tyre për krijimtarinë popullore maqedonase. Punëtoritë u mbajtën në SHFK "Ljuben Lape", SHFK "Pestaloci" dhe SHFK "Kiro Gligorov" dhe në kopshtin "Orce Nikolov".

Fëmijët patën mundësi të njihen me krijimtarinë popullore maqedonase dhe të përgatisin bizhuteri, filigran nga sërma (pafta), krijuan punime me lesh, pe, me të cilat dekoronin shishet e qelqit dhe nga e gjithë kjo dolën dekorime të shkëlqyera që janë sinonim i krijimtarisë popullore maqedonase.

Me këto punëtori edukative u arrit qëllimi, sepse fëmijët u nxitën të këmbëngulnin në realizimin e asaj që kishin paramenduar dhe përmes këtyre punëtorive interesante u ndërgjegjësuam për talentin që posedojnë. Fëmijët mësuam shumë, mësuam se cilat instrumente, bizhuteri dhe dekorime janë pjesë e krijimtarisë popullore maqedonase dhe të gjithë ata që morën pjesë në këto punëtori u përqendruan në ndërtimin e talentit të tyre dhe me sukses promovuan dhe afirmuan atë.

Të gjithë nxënësit që morën pjesë në punëtoritë e krijimtarisë popullore maqedonase morën certifikata për pjesëmarrje në punëtori.



## 2. Punëtori për mentorim krijues

IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh nga data 28 mars deri më 31 maj 2022, për herë të katërt, nëpërmjet një sërë punëtorish, realizoi punëtori për mentorim krijues. Punëtoritë janë të konceptuara në një mënyrë të tillë ku njohuritë dhe përvojat shkëmbehen në një marrëdhënie mentor-pjesëmarrës për tema të paracaktuara.

Punëtoritë për mentorim krijues janë të dedikuara për fëmijë dhe të rinj nga mosha 12 - 16 vjeç dhe synojnë sublimimin e kreativitetit dhe potencialit krijues të të rinjve, si bazë për rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të nxënësit.


Përzgjedhja e edukatorëve për punëtoritë e mentorimit krijues u realizua nëpërmjet thirrjes publike. Punëtoritë u zhvilluan në lokacione të ndryshme në ambient të hapur (punë në terren) dhe në ambientet e QKF-Karposh. Nxënësit-pjesëmarrës të këtij projekti me ekspertë-mentorë dhe nëpërmjet një sërë ligjëratash dhe vizitash në objektet kulturore arritën një nivel më të lartë kreativiteti dhe inventiviteti dhe e gjitha kjo u përkthye në një produkt të përfunduar nga fusha e industrive kreative. Nxënësit të cilët u regjistruan për të marrë pjesë në punëtoritë që ishin në interesin e tyre arritën të përmirësojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre, të mësojnë diçka të re, të gjejnë veten dhe në fund të promovojnë punën e tyre.

Në punëtoritë për fotografi digjitale, teknika antike të pikturës - ikonografi, nga Glinamol në Art Deko - qeramikë, punëtori që u zhvillua në Muzeun Arkeologjik, si dhe “Shkup VLOGGING TOUR” ose guidë të rinj turistikë, u regjistruan dhe morën pjesë 80 nxënës, pra 4 punëtori me 20 fëmijë patën mundësinë të nxjerrin të shpalosin krijimtarinë e tyre sipas afinitetit. Nxënësit patën mundësinë të përfshihen drejtpërdrejt në punëtori dhe ligjëratat dhe nëpërmjet angazhimit të tyre të drejtpërdrejtë në fushën e kulturës të arrijnë qëllimin e dëshiruar.

Me mbështetjen e edukatorëve që dhanë maksimumin në realizimin e këtyre punëtorive kreative, duhet të theksojmë se krijuesit e rinj u ndanë shumë të kënaqur me përpjekjet që bënë dhe punuan me shumë entuziazëm në punëtori dhe në fund me krenari prezantuan kryeveprat e tyre.

Për kënaqësinë e përgjithshme të të gjithëve ne, për të katërtën herë, interesimi për këtë lloj punëtorish krijuese ishte i madh këtë vit, ndaj mund të themi me plot besim se ia arritëm qëllimit. Vetë nxënësit treguan se kishin nevojë për një freskim të tillë njohurish dhe erdhën me shumë entuziazëm në punëtoritë.







### **3. Maratona e leximit**

Maratona e leximit është një projekt ku krijohen mundësi për autorët që shkruajnë letërsi për fëmijë dhe të rinj. Krenarë për një tjetër projekt tonin, dhe të frymëzuar nga sukcesi i vitit të kaluar i romanit "Gjuetarët e lajmeve të rreme nga ndërtesa 39" të shkrimtarit Ognen Nedelkovski, "Qendra Kulturore për Fëmijë" - Karposh me mbështetjen e Qytetit të Shkupit në kuadër të manifestimit "Maratona e Leximit", këtë vit për herë të dytë shpalli dhe realizoi Konkursin për vepër origjinale në prozë për adoleshentë, në zhanrin e romanit, novelës apo përmbledhjes me tregime. Për këtë qëllim u formua një komision prej tre anëtarësh, i cili vazhdoi menjëherë me përcaktimin e kriterëve të konkursit. Kriteret në konkurs ishin: veprat e paraqitura letrare (roman, tregim i gjatë...) të kenë formë rrëfimi, të kenë së paku 50 faqe kompjuterike, të jenë të dedikuara për fëmijë të moshës 10-15 vjeç, të jenë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe të mos jenë botuar më parë. Konkursi për vepër origjinale në prozë për adoleshentë u shpall më 10.02.2022.

Komisioni tre anëtarësh i ekspertëve, i kryesuar nga Aleksandar Prokopiev, zgjodhi dorëshkrimin "Ruga e lindjes së diellit" të Vesna Apostolovskit.

Promovimi i sivjetshëm i romanit të përzgjedhur për adoleshentë "Ruga e lindjes së diellit" nga autorja Vesna Apostolovski, këtë vit në bashkëpunim me Bibliotekën e qytetit "Vëllezërit Miladinov" - Shkup kishte promovimin e tij pikërisht në bibliotekë më 02.09.2022 nga ora 19:00 deri ora 20:00.

Letërsia për adoleshentët mungon te lexuesit dhe pikërisht për këtë ne si institucion filluam me këtë nismë. Me këtë iniciativë u japim mundësinë adoleshentëve të kenë literaturën e tyre të aksesueshme. Natyrisht, këtë ide e lidhim edhe me bibliotekat e rrugës, të cilat janë aktive në qytetin tonë tashmë katër vite, ndaj edhe ky roman do të gjendet në to.



#### 4. Kori i fëmijëve gazmorë - „Zëri i Fëmijëve të Shkupit“

Në Parkun e Qytetit të GUASKA, nga ora 12.00-13.00, më datë 14.05.2022, IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh, organizoi dhe realizoi promovimin e CD-së së re të 4-të me 10 këngë të reja të korit për fëmijë, të realizuara nga kori i qytetit për fëmijë "Zëri i Fëmijëve të Shkupit". Kori i qytetit për fëmijë "Zëri i Fëmijëve të Shkupit" është i dedikuar për fëmijë dhe të rinj që posedojnë talent të jashtëzakonshëm në këndim solo dhe në kor. Nëpërmjet audicioneve gjatë vitit u zgjodhën fëmijë të talentuar që janë pjesë e korit, i cili vit pas viti shton anëtarësimin e tij.

Këtë vit ka pasur shumë interes për eventin, pra për promovimin e CD-së së re. Çdo këngë e promovuar shoqërohej me koreografi autentike. Publiku, dhe veçanërisht fëmijët që ndoqën eventin, shijuan çdo këngë të interpretuar, kënduan së bashku me fëmijët e korit dhe arritën të mësojnë koreografinë e këngëve. Pamja ishte e bukur, fëmijët nga publiku kënduan dhe kërcyen çdo këngë dhe e gjithë performanca u kthye në një festë të madhe. Një tjetër CD me 10 këngë të reja origjinale është dëshmi e mëtejshme se fëmijët e duan muzikën e korit dhe ky kor i qytetit për fëmijë është një rifreskim i vërtetë në skenën muzikore për fëmijë.







## **5. Festivali dhe konkursi ndërkombëtar për kitarë klasike - TREMOLO**

IP "Qendra Kulturore për Fëmijë" - Karposh nga data 1 qershor deri më 8 qershor 2022 organizoi dhe realizoi me sukses edicionin e 13-të të Festivalit dhe Konkursit Ndërkombëtar të Kitarës Klasike - Tremolo, i cili është i pari dhe i vetmi i këtij lloji në vendin tonë. Me realizimin e suksesshëm të Festivalit - Tremolo, "Qendra Kulturore për Fëmijë" - Karposh jep një stimul dhe mbështetje të madhe për zhvillimin dhe promovimin e këtij lloji arti në vendin tonë.

Në Festival u mbajtën katër mbrëmje koncertesh dhe konkurse në një edicion virtual. Garat u zhvilluan në të 7-të kategoritë e nxënësve, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë në të cilat u regjistruan 35 konkurrentë.

Edicioni i sivjetmë i 13-të i Festivalit Ndërkombëtar dhe Konkursit për Kitarë Klasike - Tremolo më 04.06.2022 në orën 19.30 në Daut Pashin Amam u hap nga Drejtoresha e QKF - Karposh Dr. Biljana Lalçevska Serafimovska dhe drejtori artistik i Tremolo, Darko Bage, e pastaj festivali vazhdoi me koncertin e fituesit të vitit të kaluar të Festivalit Tremolo 2021, Luka Romaneli nga Italia.

Në koncertin e dytë, të pranishmit shijuan tingujt e kitarës në interpretimin e Milosh Vuković nga Serbia. Koncerti u mbajt në orën 19:30 të datës 06.06.2022 në Muzeun e Luftës Maqedonase.

Koncerti i tretë u mbajt në Filarmoninë e Maqedonisë më 06.07.2022 nga ora 19:30, ndërsa të pranishmit e shijuan koncertin e realizuar nga virtuoz i flamengos, Hose Karlos Gomez nga Spanja. Në këtë koncert si publik ishin të pranishëm ambasadori dhe zëvendës ambasadori i Spanjës, si dhe i gjithë ekipi i Ambasadës Spanjolle në Shkup. Në koncert ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga ambasadat gjermane, suedeze, kroate, çeke dhe kineze në RMV.

Me koncertin e katërt, me krenari mund të themi se kemi përfunduar me sukses festivalin dhe konkursin ndërkombëtar për kitarë klasike Tremolo, i cili po ashtu u mbajt në Filarmoninë e Maqedonisë më 06.08.2022, me fillim nga ora 19:30 në të cilin performoi i papërsëritshmi Goran Krivokapiq nga Mali i Zi.

Anëtarë të jurisë ndërkombëtare nga jashtë dhe nga vendi ynë, këtë vit në Konkursin Ndërkombëtar të Kitarës Klasike Tremolo ishin: Xhevdet Sahatxhija nga Kroacia/Kosova, Goran Krivokapiq nga Mali i Zi, Hose Karlos Gomez nga Spanja, Stela Miteva Dinkova nga Bullgaria, Zoran Aniq nga Serbia, Borçe Naumovski dhe Ljubomir Naçevski nga Maqedonia, Stefan Trifan nga Rumania, Erhan Mujka nga Kosova.

Çmimi kryesor i këtij edicioni të festivalit Tremolo, i takoi kitaristit të ri me perspektivë nga Rumania, Bogdan Mihailesku.



Festivali i 13-të u prezantua në shumë media dhe portale të shkruara dhe elektronike. Drejtoresha e QKF "Karposh" Dr. Biljana Lalçevska Serafimovska foli për Festivalin në kanal televiziv MRTV, TV Sitel.



## 6. Instrumentet e të parëve të mi

Nga data 15-18 prill “Qendra Kulturore për Fëmijë” – Karposh organizoi dhe realizoi festivalin dhe konkursin e instrumenteve popullore dhe klasike “Instrumentet e të parëve të mi”.

Aktiviteti u realizua në dy pjesë, një shfaqje revyale dhe një pjesë konkurruese.

Në pjesën revyale në Sallonin 19/19 - në “Qendra Kulturore Informative” me fillim nga ora 19:30, me tingujt e daulles dhe performancën e anëtarëve që ndjekin seksionin e muzikës për të studiuar instrumentet tradicionale në QKF-Karposh, si dhe me performancën e virtuozëve të njohur maqedonas, filloi edicioni i katërt i festivalit të instrumenteve popullore dhe klasike, "Instrumentet e të parëve të mi". Përveç orkestrës popullore për fëmijë në QKF-Karposh, në shfaqjen revyale, të pranishmit patën kënaqësinë të ndjekin performancat e të papërsëritshmit Stefçe Stojkovski, ish-anëtar i QKF Karposh, i cili ishte edhe anëtar i komisionit të jurisë këtë vit. Në hapje performuan edhe Bobi Spasenovski, Ljupço Sokolovski, Stevan Hristovski dhe Milan Kacarski, si dhe drejtori artistik i festivalit Novica Sokolovski. Këtë vit mbështetje për festivalin dha SHSHMB “Ilija Nikolovski Luj” nën mentorimin e prof. Melita Ivanovska dhe duoja për fizarmonikë nga shkolla e fizarmonikës e prof. Milan Kacarskit. Në këtë pjesë revyale, nëpërmjet tingujve të instrumenteve popullore tradicionale, publiku udhëtoi në krahina dhe rajone të ndryshme të vendit tonë.

Më 16 prill gjithashtu në Sallonin 19/19 u mbajt pjesa konkurruese e cila përbëhej nga dy disiplina të veçanta

- Instrumente burimore dhe grupe
- Instrumente klasike dhe grupe

Më shumë se 40 konkurrentë u ndanë në tri kategori. Kategoria e parë deri në 14 vjeç, kategoria e dytë deri në 16 vjeç dhe kategoria e tretë deri në 18 vjeç. Fituesve dhe pjesëmarrësve në të gjitha kategoritë iu ndanë diploma, ndërsa çmimi i madh u takoi garuesve të grupit vokal meshkuj nga seksioni i muzikës dhe vallëzimit tradicional me mentorin e tyre prof. Melita Ilievska.

Nëpërmjet këtij festivali dhe konkursit kulturor të instrumenteve popullore dhe klasike, përmes magjisë së tingullit të: kavallit, dajres, daulles, klarinetës, gajdes, fizarmonikës, fëmijët që ishin në numër të madh na treguan se ka ende një dëshirë dhe dashuri të madhe për studimin e instrumenteve popullore burimore.

Me këtë festival “Instrumentet e të parëve të mi”, nëpërmjet tingullit të instrumenteve popullore, ne rrëfejme tregime popullore që flasin për të kaluarën, ndërsa në të tashmen ndërtojmë të ardhmen, duke hedhur themele të reja për pasurimin e trashëgimisë kulturore.





## 7. ALFABETI ZOO 4

“Qendra Kulturore për Fëmijë - Karposh” me mbështetjen e Qytetit të Shkupit promovoi dhe realizoi me sukses projektin multimedial të titulluar “Alfabeti ZOO 4”. Projekti u realizua në "Kopshtin Zoologjik" më 4 qershor 2021 nga ora 12:00. Në promovim u interpretuan këngët nga edicioni i ri i katërt i CD-së edukative muzikore me 5 këngë të reja dhe një libër për ngjyrosje.

Promovimi i "Alfabeti ZOO 4", për kënaqësinë tonë të madhe, u realizua me sukses si edhe tri edicionet e kaluara të Alfabetit ZOO 1, 2 dhe 3. Edicioni i katërt ishte me pesë këngë të reja për kafshët: bizon, gibbon, jaguar, rrëqebull dhe okapi, kafshë që janë banorë të Kopshtit zoologjik. Këngët u kënduan nga pesë fëmijë të talentuar, ndërsa si shoqërues i promovimit mori pjesë kori i QKF-Karposh "Zëri i Fëmijëve të Shkupit".

Të ftuar këtë vit ishin fëmijët e kopshtit “Bota e ngjyrave”, si dhe fëmijët vizitorë që ndodheshin në Kopshtin Zoologjik në ato momente. Ata të gjithë patën mundësinë të vizatojnë dhe të ngjyrosin në librin e ri të ngjyrosjes “Alfabeti ZOO 4”, si dhe të ndjekin refrenet e reja për 5 kafshë të tjera. Si hyrje para çdo kënge me tregime interesante për kafshët, se si i ruajnë ato, çfarë hanë, në çfarë kushtesh jetojnë dhe nga cili kontinent kanë ardhur, u tregoi kujdestari i njohur i Kopshtit zoologjik Vojo Ivanov.

Projekti u prezantua nga shumë medime të shkruara dhe televizive.



# ЗОО АЗБУКА 4

5 НОВИ ХИТОВИ!  
ЦД, БОЕНКА  
И НОТНА ТЕТРАТКА





## **8. Festivali i baletit klasik dhe vallëzimit modern**

Adhuresit e artit të baletit dhe vallëzimit modern nga data 14.06 deri më 16.06.2022 kishin mundësi të ndjekin Festivalin e baletit klasik dhe vallëzimit modern, i cili është unik në vendin tonë. Në Operën dhe Baletin Kombëtar, IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh me mbështetjen e Qytetit të Shkupit dhe Operës dhe Baletit Kombëtar, të pranishmit ndoqën realizimin e edicionit të dytë të këtij festivali, i cili në tri mbrëmje baleti me shfaqjet e shkëlqyera dhe vallet e bukura e çuan publikun në këmbë. Hapja e festivalit ishte një spektakël i vërtetë.

Më datë 14.06. nga ora 20:00, publiku i Shkupit përjetoi një kënaqësi të vërtetë me shfaqjet “Sheherazade” dhe “Nata e Walpurgis”, shfaqje e cila u luajt pas 73 vjetësh. Shfaqjet u interpretuan nga Ansambli i Operës dhe Baletit Kombëtar.

Në hollin e objektit u bë ndarja e certifikatave të mirënjohjes dhe përkujtim i rëndësishëm për Aleksandër Dobrohotovin, të cilit pas vdekjes, familjes së tij iu nda çmimi për arritje jetësore dhe një statuetë. Festivalin në mënyrë solemne e hapi drejtoresha e QKF-Karposh, dr. Biljana Lalçevska Serafimovska. Emilia Xhipunova ndau kujtimet e saj për Dobrohotovin, ndërsa u shfaq edhe një video-projeksion kushtuar Dobrohotovit, ku primabalerina Natka Penushliska Mitrevska dhe doajeni i artit të baletit Ekrem Husein folën për arritjet e tij në artin e baletit. Për festivalin foli edhe drejtoresha artistike e festivalit, Maja Karevski, magjistër i pedagogjisë së baletit.

Në të tria mbrëmjet e festivalit, publiku pati mundësinë të shikonte dhe shijonte baletin klasik, kërcimet moderne, kostumet dhe koreografitë e bukura të realizuara nga fëmijët, nga më të vegjlit 3 vjeç deri tek adoleshentët 18 vjeç.

Në mbrëmjen e dytë të festivalit më 15.06. nga ora 20:00, të pranishmit ndoqën shfaqjet e një sërë studiosh baleti nga i gjithë vendi. Publiku pati mundësinë të shikonte 200 balerinët dhe balerinat, anëtarë të studiove të baletit. Së pari performuan fëmijët pjesëtarë të seksionit të baletit të “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh. Më pas vijoi Studioja e Baletit "Balerina", performanca solo e Olja Todorovskës, e cila është pjesë e studios së baletit të “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh “Studio e Baletit Diadema” - Shkup, “Dance Studio ULTRA” nga Kumanova, “Beatrix Crew”, dhe “iDance Studio” nga Gostivari, “Studio Mak Dance” nga Kumanova, OOMBU “Lazo Micev” - Rale.

Mbrëmja e tretë e festivalit u mbajt më 16.06. nga ora 20:00, kurse festivali u mbyll me pikat e baletit të performuara nga balerinat e talentuara të seksionit të baletit të shkollës së muzikës “Ilija Nikolovski Luj” dhe të Fakultetit të Artit Muzikor - seksionit të pedagogjisë së baletit. Në natën e tretë vëmendje e veçantë iu kushtua balerinës së re Stefanija Geshtarska

dhe iu nda mirënjohje dhe një statuetë, sepse është e vetmja balerinë nga vendi ynë në historinë e baletit maqedonas, e cila filloi shkollimin në balet në Shkup, dhe e vazhdoi dhe përfundoi si studentja më e mirë, me shumë vlerësime në shkollën më prestigjioze të baletit, “Akademia e Baletit Bolshoj” në Rusi.



## 9. Festivali i krijimtarisë fëmijërore –TRAMBOLINI

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh është gjithmonë e gatshme të zgjojë aftësitë krijuese të fëmijëve dhe me mbështetjen e Qytetit të Shkupit për herë të tretë nga 09.06 deri më 21.06 2022 organizoi dhe realizoi Festivalin e Krijimtarisë Fëmijërore “Trambolini”. Punëtoritë ishin nga fusha të ndryshme për fëmijë nga 5 deri në 18 vjeç dhe u regjistruan mbi 100 fëmijë.

Punëtoritë sipas programit Trambolini nisën më 9 qershor me 3 punëtori në ditë. Punëtoritë ishin nga fusha të ndryshme, të cilat u realizuan me tema ku fëmijët mund të ngrinin nivelin e tyre kulturor, por edhe punëtori ku fëmijët zhvilluan potencialin e tyre krijues.

Këtë vit u mbajtën punëtori si: “Botanistët e vegjël”, “Çanta ime kreative”, punëtori në pikturë, “Zozi Bushavko” (punëtori në gjuhën turke) pjesë muzikore për fëmijë dhe të rinj “Broadway JR”, me perfoermancën e pjesës muzikore legjendare Eni, punëtori për vallëzim “DanceStudio Vibe”, “Udhëtarë të kohës” në Muzeun e Artit Bashkëkohor - Shkup, Shkrimi kreativ në Bibliotekën e qytetit “Vëllezërit Miladinov”, “Qyteti i Baltazarit” - alkimistë të rinj, Arkeologë të vegjël - lokaliteti arkeologjik Tumba Maxhari, “Stop Animacion”, “Zhvillimi personal”, “Oborri i kinemasë” në bashkëpunim me Kinotekën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, punëtori - Aksesorë mode prej gline si detaj i modës dhe debat në Shtëpinë e Evropës në Shkup, ku u debatua për krijimtarinë dhe letërsinë për fëmijë me prof. Vesna Mojsova - Çepishevska, Prof. Dr. Ana Martinoska dhe psikologe dhe psikoterapeut Radmila Zhivanoviq. Debatin e udhëhoqi Ana Jovkovska.

Mbyllja e festivalit Trambolini ishte më 21 Qershor nga ora 20:00-22:30 te “Guaska” në Parkun e qytetit.

Gjatë mbylljes së festivalit u pikturua një telajo e madhe nga frymëzimi aktual nga festivali, ndërsa piktorët kryesorë ishin anëtarë të seksionit të pikturës në QKF - Karposh. Një programi i pasur u shfaq në mbyllje të festivalit ku morën pjesë zhonglerë, pantonimistë, performanca e korit të fëmijëve “Zëri i Fëmijëve të Shkupit”, performanca e seksionit të baletit të QKF - Karposh dhe gjithsesi si një surprizë e veçantë, punëtorja e titulluar “Kërkimi për thesarin e humbur”. Për herë të parë në festival u shfaq një shfaqje baleti me animacion në sfondin e “Guaska” në Parkun e qytetit.

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh edhe këtë vit inkurajoi fëmijët që të shprehin aftësitë e tyre krijuese në fushën e teatrit, artit figurativ dhe muzikor, zhvillimit personal, debatit të hapur me ekspertë në temën e krijimtarisë, shkencave natyrore, shfaqjeve të filmave, kërcimit, ekspozitave, konkurseve. Fëmijët në këtë festival unik arritën të zotërojnë teknika të reja të shprehjes krijuese në një mënyrë argëtuese dhe kreative.

“Qendra Kulturore për Fëmijë” – Karposh si institucion arriti të përgatisë një festival kreativ, argëtues plot kreativitet të fëmijëve.







## **10. Festivali ndërkombëtar i fëmijëve "VALLE PA KUFÏ"**

IP "Qendra Kulturore për Fëmijë" - Karposh në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit, nga data 16 deri më 18 shtator 2022, organizoi dhe realizoi Festivalin e 31-të Folklorik Ndërkombëtar për Fëmijë "Valle pa kufi" - simbol i miqësisë mes fëmijëve.

Festivali filloi më 16 shtator me një sërë punëtorish të mbajtura në Qendër. Punëtoritë u titulluan "Vallja frymëzim i përhershëm". Krahas punëtorive, pati edhe edukim dhe ekspozitë me veshje popullore nga krahina të ndryshme të vendit. Fëmijët që morën pjesë në punëtori bënë detaje të modës për kostumet (karfica, rripa, gjerdanë). Detajet e modës ishin prej mëndafshi, rruazash dhe materiale të tjera specifike për veshjet popullore maqedonase.

Në festival ishin ftuar dhe morën pjesë mysafirë nga Serbia - Krushevac, si dhe ansamble maqedonase: seksioni folklorik nga QKF "Karposh", "Sushevski Biseri", "Srpski Vez" nga Kumanova, "Efrem Karanov" nga Kratova, "Emin Duraku" dhe Shoqëria folklorike "Blazhevski" nga Tetova.

Nëpërmjet koloritit të kostumeve dhe origjinalitetit në lëvizjet koreografike, valltarët fëmijë prezantuan traditën dhe kulturën dhe formuan për të 31-ën herë një valle të madhe pa kufi.

Manifestimi qendror u mbajt më 17 shtator në shtëpinë e ARM-së nga ora 19:00, ndërsa festivalin e hapi drejtoresha e QKD "Karposh", Dr. Biljana Lalçevska Serafimovska.

Për kënaqësinë e madhe të "Qendra Kulturore për Fëmijë"- Karposh, në aktivitetin qendror kishte shumë spektatorë, adhurues të valleve dhe këngës. QKF-Karposh me seksionin folklorik do të vazhdojë të kultivojë këtë festival të këngëve dhe valleve popullore, për të përhapur miqësinë mes fëmijëve. Festivali tregon bukurinë dhe rëndësinë e folklorit, kërcimit dhe frymëzon të rinjtë për të vazhduar traditën 31-vjeçare.





## 11. Pjesëmarrje ndërkombëtare – Pjesëmarrje e seksionit folklorik pranë IP “Qendra Kulturore për Fëmijë”- Karposh në Kushadasi, Republika e Turqisë

Nga data 18 deri më 22 maj 2022, fëmijët - anëtarë të seksionit folklorik në QKF-Karposh u ftuan të marrin pjesë në Festivalin Ndërkombëtar Folklorik për Fëmijë në Kushadasi, Republika e Turqisë. Karposhasit patën një performancë të shkëlqyer dhe interpretuan vallet si profesionistë të vërtetë: Povardarie, Tropnalo, Vallet e qytetit, vallja Pajdushko. Folkloristët u brohoritën dhe duartrokitën nga të pranishmit, të cilëve iu prezantua se si luhet dhe kultivohet folklori dhe tradita maqedonase. Përveç koncertit, folkloristët u nderuan edhe nga kryetari i Komunës së Kushadasit. Është krenari të prezantosh folklorin tënd në një festival ndërkombëtar.



## II. MANIFESTIME TË BRENDSHME, PROJEKTE DHE EKSPOZITA TË QKF - KARPOSH

### 1. Kërcej dhe këndoj për nënën time

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh organizoi dhe realizoi manifestimin muzikor kreativ, ku nëpërmjet valleve, muzikës, vizatimit dhe krijimtarisë letrare u shënuar Dita e Gruas, 8 Marsi. Manifestimi kryesor u mbajt më 05.03.2022 në Kinotekën e Republikës së Maqedonisë së Veriut me fillim nga ora 12:00, ku fëmijët përmes vallëzimit dhe muzikës uruan të gjitha gratë, veçanërisht nënat e tyre.

Në manifestim me repertorin e tyre performoi kori i QKF Karposh - "Zëri i Fëmijëve të Shkupit", balerinat e vogla nga studio e baletit "Balerina", si dhe fragmente të pjesës muzikore "E bukura dhe bisha", interpretuar nga Studio e Muzikës për Fëmijë. Manifestimi vazhdoi më 07.03.2022 në ora 13:00 në bashkëpunim me SHFK “Kiro Gligorov” me shkrim kreativ në temën "Me dashuri për të gjitha gratë", si dhe lexim letrar me poezi të poezisë të dedikuar për gratë.




Përmbyllja e manifestimit ishte më 03.08.2022 me ekspozitën tradicionale të vizatimeve nga fëmijët e institucioneve parashkollore në Qytetin e Shkupit dhe rethinave, të cilët morën pjesë në konkursin e publikuar me temën “Vizatoj për nënën time”. Fëmijët e kopshtit përgatitën kartolina urimi dhe vizatime me temën “Gruaja – nënë”, të cilat tregojnë kreativitetin dhe imagjinatën e tyre se si i perceptojnë nënat e tyre dhe cili është roli i nënës në jetën e tyre dhe sigurisht gruas në përgjithësi. Me pjesëmarrjen e saj si e ftuar këtë vit na nderoi Snezhana Balkanska – valltare dhe këngëtare profesioniste – Instruktoreshë Folklorike në IK “Tanec”, e cila foli për profesionin e saj.

Ekspozita me punime të fëmijëve u vendos në ambientet e QKF “Karposh”. Ajo u prezantua gjithashtu në internet më 8 mars 2022 në orën 10:30 në faqen e Qendrës në Facebook dhe kanalën YouTube, në mënyrë që audiencia e gjerë ta shohë atë.

<https://www.youtube.com/watch?v=-y02CzIYKsc&t=13s>

<https://www.youtube.com/watch?v=U1Ng3zFTBZc&t=5s>





## 2. Pjesëmarrje e korit të fëmijëve „Zëri i Fëmijëve të Shkupit“ në manifestimin vjetor në SOS “Fshati i Fëmijëve”

Më 12.03 në SOS “Shtëpia e Fëmijëve” u ftua të performojë kori i qytetit për fëmijë "Zëri i Fëmijëve të Shkupit" nga QKF - Karposh me këngët nga CD-ja e fundit më e re. Për kënaqësinë tonë të madhe, Qendra ishte pjesë e manifestimit vjetor për dhënien e mirënjohjeve mbështetësve më të mëdhenj të SOS “Fshati i Fëmijëve”. Ishte privilegj të ishte pjesë e këtij eventi. Ne do t'i mbështesim me kënaqësi edhe në të ardhmen me moton tonë "Nga fëmijët për fëmijët".





### 3. Kuizi i nxënësve - 2022/2023

IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh është organizator dhe realizues i kuizit tradicional të nxënësve për njohuri të përgjithshme për të gjitha shkollat fillore në Shkup dhe rrethinë.

Kuizi i nxënësve filloi me ciklin e parë nga shtatori 2022 dhe zgjat deri në maj 2023. Në ciklin e parë, 40 shkolla fillore nga Shkupi dhe rrethinat morën pjesë në 8 gara.

Garat ishin të njohurive të përgjithshme dhe u zhvilluan 5 raunde. Kuizi është i natyrës konkurruese dhe fëmijët iu përgjigjën pyetjeve nga fusha e historisë, gjeografisë, kimit, fizikës, si dhe pyetjeve nga kultura e përgjithshme.

Fëmijët që konkuruan në këtë aktivitet interesant dhe edukativ kishin mundësi të testojnë njohuritë e tyre.





#### 4. Konkursi në pikturë me rastin e 1 Prillit – Dita e shakasë

Qendra kulturore për fëmijë - Karposh, me rastin e 1 Prillit, ditës së shakasë në Qendër realizoi ekspozitën me temën "Gënjeshtrat e Prillit".

QKF - Karposh, shpalli konkurs në pikturë dhe e dërgoi në të gjitha shkollat fillore të qytetit të Shkupit. Të gjithë nxënësit e klasës së 5-të deri në të 9-ën kishin mundësi të regjistrohen në konkurs, ndërsa punimet ishin me temën "Gënjeshtrat e Prillit". Në ekspozitë u shfaqën punime artistike, karikatura dhe maska të punuara me dorë nga të gjithë fëmijët e regjistruar.

Si çdo vit, fëmijët nga shkollat e Shkupit dërguan vizatime të bukura, karikatura dhe maska të cilat u ekspozuan në qendër, ekspozita mund të vizitohej për 10 ditë. Si një vëmendje e vogël, por domethënëse, çdo shkollë mori një certifikatë mirënjohjeje për punimet e krijuara.

Ekspozita u vendos në QKF - Karposh me datë 01.04.2022 në orën 12:00. Përveç nxënësve që vizituan ekspozitën me vizatimet, karikaturat dhe maskat e bukura, ekspozita u shfaq edhe online në faqen e FB të Qendrës dhe arriti një shikueshmëri prej mbi 1.000 ndjekës në faqen FB të QKF-Karposh.

<https://www.facebook.com/dkckarposh/videos/697095561468159>





## 5. Dita e shëndetit – Garë krosi


Qendra Kulturore për Fëmijë - Karposh organizoi për herë të parë sivjet më 7 Prill garën e krosit për Ditën Ndërkombëtare të Shëndetësisë.

Në këtë aktivitet sportiv morën pjesë fëmijë nga kopshtet e qytetit dhe përreth. Gara u zhvillua në pistën e tartanit në Parkun e Qytetit me fillim nga ora 11:00 dhe u zhvillua në 250 m. në kategori të përzier, djem, vajza. Krahas garës u zhvillua edhe një garë stafetë 200 metra 4x50 metra.

Në këtë manifestim sportiv u regjistruan 17 kopshte me gjithsej 170 pjesëmarrës (85 djem dhe 85 vajza).

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte shënimi i ditës ndërkombëtare të shëndetit dhe dërgimi i një mesazhi PËR JETË TË GJATË E TË SHËNDETSHME, MERRUNI ME SPORT.

Sporti dhe mënyra e shëndetshme e jetesës do të kontribuojë për një jetë të gjatë dhe të shëndetshme.





## 6. Vizatim në asfalt

“Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh sivjet organizoi tradicionalisht manifestimin "Vizatim në Asfalt", në të cilin marrin pjesë më të vegjlit, përkatësisht fëmijët nga të gjitha çerdhet e Shkupit dhe rrethinave. Ky manifestim i kushtohet ditës së arsimtarëve maqedonas Shën Kiril dhe Metodij, të cilët janë një nga figurat më domethënëse në historinë e Maqedonisë.

QKF Karposh për këtë manifestim siguroi materiale vizatimi (shkumësa me ngjyra) dhe organizoi një program të përshtatshëm, si dhe njohjen e fëmijëve me kuptimin dhe arsyen pse kjo ditë e madhe festohet si festë. Fëmijët e institucioneve parashkollore, ashtu si vitet e kaluara, shprehën kreativitetin e tyre me vizatimet në asfalt, të cilat ishin sipas zgjedhjes së lirë.

Manifestimi u mbajt në PLOÇNIK më 23.05. 2022 duke filluar nga ora 10.30. Në “Vizatim në Asfalt” morën pjesë 17 kopshte me nga 20 fëmijë, 10 vajza, 10 djem.







## 7. Shkolla verore për gjuhë turke me Yunus Emre Enstitüsü - Shkup

Nga data 15 korrik deri më 15 gusht u mbajt shkolla verore në gjuhën turke në bashkëpunim me Yunus Emre Enstitüsü - Shkup. Për kënaqësinë tonë të madhe, u regjistruan 20 fëmijë dhe u formuan 2 grupe. Me këtë shkollë verore, fëmijët e kaluan verën në mënyrë produktive, me mundësi që të njohin nga afër kulturën turke me aktivitete të ndryshme dhe mësimin e gjuhës turke.

Krahas aktiviteteve, krijimi i veprave artistike Ebru, gjuajtja me shigjetë në Çifte Amam, orë mësimi në gjuhën turke, ora e kaligrafisë, orë muzike me prof. Timko Ciçakovski, fëmijët shijuan edhe ushqimet e mrekullueshme turke.

Në Çifte Amam fëmijët patën mundësinë të shikojnë ekspozitën e jashtëzakonshme të Ivanço Talevskit dhe të frymëzuar prej saj krijuan veprat e tyre. Një kënaqësi e vërtetë me Ebru Art, fëmijët mësuuan çdo ditë teknika të reja pikturë nga Ebru Art. Në Daut Pashin Amam fëmijët patën mundësinë të shohin edhe ekspozitën e Kondovskit.

Përshkrim i një dite të shkëlqyer, plot me aktivitete, ishte sipas kësaj radhitjeje.

**- Fëmijët në orën e muzikës këndonin këngën "Vardar Ovası", pastaj vijon ora e gjuhës turke, dhe në fund shijuan dürüm köfte dhe ajran më të shijshëm.**

Shkolla verore ishte një sukses i plotë. Fëmijët morën mësim në gjuhën turke, artin Ebru, kaligrafi, gjuajtje me shigjetë, mësuuan pak muzikë turke dhe u njohën me instrumentet muzikore turke dhe provuan ushqime turke. Një pushim veror i shkëlqyer, plot miqësi dhe i kaluar në mënyrë produktive, i cili do të mbetet një kujtim i mrekullueshëm për fëmijët që ndoqën këtë shkollë verore.









## 8. Pjesëmarrje në manifestimin humanitar – „Luajmë së bashku“

Më datë 25.09.2022, nga ora 11:00, në Parkun e qytetit, u mbajt manifestimi humanitar me titull “Luajmë së bashku”, i cili u organizua nga Autizëm Mk. Në kuadër të aktivitetit “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh u bashkua me aktivitetin e saj “Kërkimi i thesarit të humbur”, i cili u zhvillua në labirintin në Parkun e qytetit.

Në labirint, mbi 100 fëmijë patën mundësinë të marrin pjesë në këtë projekt interesant. Fillimisht, për të hyrë në labirint, ata duhej të “blinin” një biletë, më pas kalonin një poligon me pajisje sportive dhe para se të futeshin në labirint, rreth labirintit kishte një rrotullim rreth pistës së tartanit me vrap.

Më pas, me sinjalin e instruktorit, të gjithë hynë në labirint së bashku për të gjetur thesarin. Shumë të qeshura dhe gëzim u përhapën nëpër labirint dhe ndërsa për zbuluesin e thesarit pati edhe çmim. Në ndërkohë, kori i qytetit për fëmijë "Zëri i Fëmijëve të Shkupit" në QKF-Karposh këndoi dhe argëtoi të pranishmit me repertorin e tij të këngëve korale për fëmijë.



## 9. Pjesëmarrje në „Nata e Bardhë“

Më 01.10.2022 në Kopshtin Zoologjik-Shkup në kuadër të projektit të tetëmbëdhjetë me radhë “Nata e Bardhë”, i cili organizohet nga Salla Universale-Shkup, QKF-Karposh mori pjesë me projektin multimedial Alfabeti Zoo. Me të 4 edicionet e këtij projekti multimedial, fëmijët e korit "Zëri i Fëmijëve të Shkupit" interpretuan të 20 këngët, të shkruara për kafshët që jetojnë në Kopshtin Zoologjik të Shkupit. Në hyrje, fëmijët-vizitorë morën një libër me ngjyra dhe një CD si kujtim të këtij eventi. Qendra edukative në Kopshtin zoologjik ishte plot me fëmijë, vizitorë që erdhën për të shijuar dhe kërcyer të 20 këngët e realizuara nga kori. Me këtë aktivitet, i cili u realizua nga QKF Karposh, “Nata e Bardhë” u bë më e pasur dhe më e mirë edhe për një aktivitet tjetër të dedikuar për fëmijët më të vegjël.





## 10. Koncert në kitarë klasike i Georgi Trajkovit

Në “Qendrën Kulturore Informativë” - Salloni 19/19 - 21.10.2022 nga ora 19:30 u mbajt koncerti i Georgi Trajkovit - kitarë klasike. Koncerti u mbajt për adhuruesit e kitarës klasike - fëmijë, anëtarë të seksionit të kitarës klasike, nxënës, studentë dhe publikun e gjerë. Në koncert mori pjesë edhe zëvendës ambasadori i Spanjës në Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi i koncertit ishte stimulimi dhe mbështetja për mësimin e kitarës klasike për fëmijët dhe të rinjtë e interesuar për këtë lloj arti. Programi përbëhej nga vepra muzikore të autorëve të njohur, por edhe këngë në aranzhimin e tyre. Trajkov luajti me mjeshtëri Rossen Balkanski-Nocturno, A.Barrios-Mangore-Un Dia di Noviembre, F.Tarrega - Capricho Arabe, A.Barrios-Mangore-Prelude in c minor, Walk Dance, Eleno kerko/Jovano Jovanke (arr. Georgi Trajkov), Roland Dyens-Tango en skai. Në koncert surprizë e këndshme për publikun ishte performanca e përbashkët e Georgi Trajkovit - kitarë klasike dhe Marko Mladenovskit i cili luante në klarinetë dhe kavall. Një koncert për t'u mbajtur mend, një koncert në një sallë të mbushur plot dhe nxënës e studentë të kitarës klasike të kënaqur.





## 11. Turne në ping – pong dhe shah

Në vitin 2022 në QFK-Karposh u mbajtën dy turne në ping-pong dhe shah. Turneu i parë u mbajt më 26 tetor, në kuadër të Javës së barazisë gjinore, mes nxënësve nga SHFK "J.H. Pestaloci" SHFK - Komuna Qendër dhe SHFK "Lazo Angelovski" - Komuna Aerodrom. Turneu i dytë u mbajt më 15 dhjetor ndërmjet SHFK "Vera Ciriviri Trena" - Komuna Gazi Babë dhe SHFK "Ljuben Lape" - Komuna Aerodrom. Në turne morën pjesë 20 fëmijë-nxënës të klasave VIII dhe IX së bashku me mentorët e tyre. Turne të shkëlqyera ku të gjithë dolën fitimtarë.



## 12. Lëviz për shëndetin

Në kuadër të Javës së lëvizjes evropiane, e cila u mbajt nga data 16.09 deri më 22.09.2022, “Qendra Kulturore për Fëmijë” - Karposh më 21.09.2022 organizoi dhe realizoi manifestimin “Lëviz për Shëndetin”, i dedikuar për fëmijët më të vegjël nga kopshtet e Shkupit.

Manifestimi është i një natyre argëtuese-rekreative dhe përfshin ushtrime për përmirësimin e zhvillimit motorik të fëmijët e moshës së hershme parashkollore.

Nga çdo kopsht u ftuan të merrnin pjesë dhjetë fëmijë nga grupi më i madh i kopshteve, të cilët bënë ushtrime të përshtatshme për moshën e tyre. Në këtë manifestim atraksion ishin çiklistët e vegjël gazmorë dhe fëmijët që drejtonin trotinetet.

U ngritën 9-të poligone trajnimi që ofronin mundësi për aktivitete dhe ushtrime të ndryshme për rritjen dhe zhvillimin e duhur të popullatës së re. Me këtë manifestim shkaktuam kënaqësi, gëzim dhe lumturi të më të vegjlit dhe në të njëjtën kohë futëm vlera të vërteta për shprehi të shëndetshme. Të gjithë së bashku thamë se shëndeti ynë është gjëja më e rëndësishme për ne dhe prandaj merremi me sport.

Aktiviteti u mbajt për të tetën herë në sheshin përballë shatërvanit Lotus në Parkun e qytetit duke filluar nga ora 10:00.









### 13. Ndërtoj qytetin tim

“Qendra kulturore për fëmijë” - Karposh edhe këtë vit tradicionalisht për nder të qytetit të Shkupit, me më të vegjlit, fëmijët e kopshteve të Shkupit, organizoi dhe realizoi manifestimin "Ndërtoj qytetin tim".

Ky manifestim ka për qëllim të nxjerrë në pah aftësitë krijuese të fëmijëve, kreativitetin e fëmijëve, dhe në të njëjtën kohë t'i njohë fëmijët me rëndësinë e festës së 13 Nëntorit për qytetin e Shkupit.

Në aktivitetin “Ndërtoj qytetin tim” këtë vit morën pjesë 14 kopshte me nga 25 fëmijë.

Me ftesën tonë, fëmijët e kopshteve të Shkupit nga grupet më të mëdha bënë modele të objekteve të rëndësishme nga qyteti i Shkupit. Objektet që ata zgjedhën për të bërë ishin zgjedhjet e tyre. Fëmijët përdorën materiale natyrale, gjethe, gurë, shumësia me ngjyrë, karton e të tjera për të bërë modelet dhe nuk lanë mënjanë as produktet e drithit, si thjerrëzat, orizin dhe kokrrat e fasuleje. Nga të gjitha këto dolën modele vërtet të bukura me ndërtesa nga Shkupi. Duke qenë se manifestimi ishte edicion virtual, kopshtet dërguan foto dhe video të bërjes së modeleve, pra fotografi se si fëmijët i bëjnë ato me kujdes dhe përkushtim. Me materialin e marrë u realizua një video, e cila u shfaq në faqen në Facebook dhe në kanalën YouTube të QKF-Karposh më 13 nëntor në orën 12:00.

<https://www.facebook.com/dkckarposh>

<https://www.youtube.com/watch?v=4MgqgL6Oz1U>







## 14. Punëtori edukative për trashëgiminë kulturore

Muaji Nëntor ishte muaji i kulturës. Me atë rast, më 18 nëntor, nxënësit e SHFK "Kiro Gligorov" ishin mysafirë në QKF-Karposh për të parë të gjithë objektin. Vizita e tyre ishte pjesë e programit kulturor që ata zhvillojnë gjatë këtij viti. Nxënësit e klasës së IV patën mundësinë të mësojnë për arkitekturën dhe rëndësinë e objektit si trashëgimi kulturore. Ata patën edhe një prezantim nga aspekti etnologjik dhe etno-koreologjik, por u njohën edhe me aktivitetet aktuale të Qendrës.





## 15. Punëtori etno - kreative

Më 5 dhjetor në SHFK "Vera Ciriviri Trena" - Komuna Qendër u mbajt punëtorja etno-kreative, ku nxënësit e klasës së dytë bënë bredhin e Vitit të Ri me motive etnologjike. Punëtorja përfshinte dy klasa me nga 30 nxënës secila. Fëmijët patën mundësinë të njihen me artin popullor maqedonas dhe ta bëjnë bredhin e Vitit të Ri duke përdorur fije dekorative, shirita, ruaza.



## 16. Ekspozitë – Filip Ciglenjak Simonovski



Me fillim nga ora 10:00 në QKF "Karposh" me datë 14.12. 2022 u hap ekspozita e parë e pikturave të artistit të vogël, por të madh Filip Cigleniak Simonovski. Ekspozita ishte e hapur dhe mund të shikohej deri më 27 dhjetor. Bora Aktash me performancën e saj në kitarë klasike hapi ekspozitën e Filip Cigleniak Simonovskit.

Ekspozitën e vizitoi bashkëshortja e Presidentit të vendit, znj. Elizabeta Gjorgjievska dhe ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, znj. Jovanka Trençevska, të cilat shikuan veprat e mrekullueshme të artit të Filipit të vogël, i cili me gëzim dhe kënaqësi u tregoi për dashurinë e tij ndaj pikturës.

Filipi është nxënës në klasën e katërt në shkollën fillore "Risto Krle" në Kadino dhe në moshën katër vjeçare, krejt rastësisht filloi të pikturojë akrilik në telajo. Që atëherë, pikturat e Filipit, i cili është me autizëm, flasin me ngjyra të forta dhe sjellin një dallgë emocionesh.

Ekspozita u organizua nga "Qendra Kulturore për Fëmijë" - Karposh, shoqata "Në botën time" dhe "Idea Lab".

Me këtë ekspozitë, Filipi tregoi se sa është i veçantë, i talentuar dhe unik.






## 17. Foto konkursi - Kafsha ime shtëpiake

QKF-Karposh këtë vit shpalli dhe realizoi për të katërtën herë radhazi foto konkursin për fëmijë dhe të rinj me temën “Kafsha ime shtëpiake”. Konkursi zgjati një muaj që të gjithë fëmijët e interesuar të regjistroheshin në këtë garë interesante, argëtuese dhe edukative. Konkursi shpallet për të nxitur ndërgjegjësimin për kujdesin dhe dashurinë ndaj kafshëve, për të motivuar fëmijët për të mbajtur kafshë shtëpiake, për t'u mësuar atyre përgjegjësinë dhe për të rritur ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe të rriturve për mënyrën e ruajtjes së kafshëve shtëpiake.

Fëmijët që mbajnë kafshë shtëpiake patën mundësinë të dërgojnë fotografi të kafshëve të tyre në adresën tonë e-mail. Nga të gjitha fotografitë e marra u bë një video, e cila u shfaq më datë 15.12.2022 në faqen e Qendrës në FB dhe kanalin YouTube. Kafshët shtëpiake të përzgjedhura u shpërblyen me certifikata dhe dhurata. Çmimet u dhanë për: kafshët shtëpiake të veshura më në modë, familjen më të lumtur, kafshën shtëpiake më gracioze, kafshën shtëpiake me veshët më të gjatë, buzëqeshjen më të bukur, kafshën më të gëzuar, krifën më luksoze, kafshën më të turpshme, shoqëruesen më besnike.



## 18. Orë publike në vigjilje të Vitit të Ri – prezantimi i seksioneve të QFK “Karposh “

Fundi më i bukur i vitit 2022 i mbushur me shumë art në një vend. Fëmijët pjesëtarë të seksioneve të QKF-Karposh na sollën një gëzim të vërtetë të gjithëve, prindërve të tyre dhe publikut të shumtë. Në orën publike në vigjilje të Vitit të Ri, kori i fëmijëve, seksioni i folklorit, baletit, studimit muzikor të kitarës klasike treguan çfarë kanë mësuar në orët e mësimit që ndoqën gjatë vitit.

Më datë 21.12.2023, në kinemanë Frosina-QKR, me fillim nga ora 19:30, filloi një kënaqësi e vërtetë. Të pranishmit ndoqën me kërshtëri piruetet e balerinave të vogla, vallëzimet dhe vallet e interpretuara nga kërcimtarët e vegjël, vizatimet e bukura të ekspozuara në hollin e kinemasë, interpretimin e kitaristëve të vegjël dhe në fund këngët e kënduara nga fëmijët e korit në QKF-Karposh “Zëri i Fëmijëve të Shkupit”. Një mbrëmje e mrekullueshme, një performancë e mrekullueshme, një audiencë e mrekullueshme, fëmijët e Karposhit me të vërtetë kishin ç’të tregonin dhe ngritën publikun në këmbë.











## 2. Riparimi dhe rikonstruksioni i bodrumit dhe katit të objektit të QKF - Karposh

IP "Qendra Kulturore për Fëmijë" - Karposh, në përputhje me nevojën për "Riparimi dhe rikonstruksioni i bodrumit dhe katit të parë të objektit" të QKF - Karposh, realizoi procedurën e prokurimit publik dhe si ofertues më i favorshëm u përzgjodh kompania "Makaus" nga Shkupi. Fillimisht kompanisë i është dërguar njoftim me shkrim për fillimin e menjëhershëm të realizimit të prokurimit. Në afatin e parashikuar sipas dokumentacionit të tenderit, kompania e përzgjedhur dhe me të cilën është lidhur kontrata realizoi punën që ishte lëndë e prokurimit publik sipas projektit bazë.



## IV. PASQYRA STATISTIKORE E NXËNËSVE

### 1. PASQYRA STATITSTIKORE E PROGRAMEVE TË MBËSHTETURA NGA QYTETI I SHKUPIT PËR VITIN 2022








## 2. PASQYRA STATITSTIKORE DHE KRAHASIMI SIPAS VITEVE I AKTIVITETEVE TË BRENDSHME NGA QKF - KARPOSH


### КËРCEJ DHE КËНDOJ ПËР НËНËН ТИМЕ – Уриме пËр 8-тË marsin

Pjesëmarrje e 20 kopshteve me nga 30 fëmijë, 15 vajza, 15 djem - Gjithsej 600 fëmijë




## KUIZI I NXËNËSVE 2022

Pjesëmarrje e mbi 40 shkollave fillore me nga 3 pjesëmarrës: 120 pjesëmarrës- 65 vajza, 55 djem




## DITA E SHËNDETIT – KROS

Pjesëmarrje e 17 kopshteve, 5 djem, 5 vajza - Gjithsej 170



## VIZATIME NË ASFALT


Pjesëmarrje e 17 kopshteve me nga 20 fëmijë, 10 vajza, 10 djem - Gjithsej 340 fëmijë






## LËVIZ PËR SHËNDETIN

Pjesëmarrje e 20 kopshteve me nga 10 fëmijë , 5 vajza dhe 5 djem -  
Gjithsej 200




## NDËRTOJ QYTETIN TIM

Pjesëmarrje e 14 kopshteve me nga 25 fëmijë, 10 vajza, 10 djem - Gjithsej  
350 fëmijë




## SEKSIONI I BALETIT

Gjithsej 64 vajza




## SEKSIONI I VALLEVE

Në dy grupe; grupi i vogël 24 fëmijë, 23 vajza, 1 djem, grupi i madh 63 fëmijë, 59 vajza, 4 meshkuj - Gjithsej 87 fëmijë




## SEKSIONI I KORIT

Gjithsej - 20 anëtarë, 18 vajza, 2 djem




## SEKSIONI I PIKTURËS

Në 2 grupe; grupi i vogël 20 fëmijë, 15 vajza, 5 djem, grupi i madh 15 fëmijë, 10 vajza, 5 meshkuj ) - Gjithsej 35 fëmijë



## KAFSHA IME SHTËPIAKE

Pjesëmarrje e 15 pjesëmarrësve - 10 vajza, 5 djem - Gjithsej 15 fëmijë







**RAPORT FINANCIAR PËR AKTIVITETET  
PROGRAMORE TË  
IP "QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË" –  
KARPOSH**

**SHKUP, 2023**

**RAPORT FINANCIAR**  
**për periudhën 01.01 - 31.12.2022**  
**për llogarinë buxhetore 7850109628-903-10**  
**të IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” – Karposh, Shkup**

Të ardhura të realizuara nga Qyteti i Shkupit

741111- Transferta nga nivele të tjera të pushtetit ..... 6.492.352

Arsyetim i zërit:

(Ky zë nënkupton mjetet të cilat janë marrë në mënyrë të dedikuar nga Qyteti i Shkupit për paga dhe kompensime për dhjetë të punësuar dhe bllok dotacionin e miratuar për vitin 2022)

Shpenzime gjithsej:

Sipas kontove:

401- Paga neto dhe kompensime ..... 4.082.100

402 – Kontribute për sigurimin social ..... 1.588.202

421 – Shërbime komunale, ngrohje etj..... 759.000

464 – Transferta të ndryshme ..... 63.050

(Pagesë për pensionim)

**RAPORT FINANCIAR**  
**për periudhën 01.01 - 31.12.2022**  
**për llogarinë buxhetore 7850109628-787-15**  
**të IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” – Karposh, Shkup**

Gjithsej të ardhura të realizuara sipas grupeve:

723- Taksa dhe kompensime ..... 695.210

(Ky zë nënkupton të ardhura nëpërmjet pagimit të anëtarësimeve sipas seksioneve në institucion nga fusha e kulturës, qiradhënie e objektit)

725 – Të ardhura të tjera jostatimore ..... 414.653

(Ky zë nënkupton të ardhura nga pagimi i dëmit nga sigurimi)

741 – Saldo e bartur nga viti 2021..... 134.138

Gjithsej shpenzime sipas kontove:

420 - Shpenzime rruge dhe ditore ..... 31.251

(Ky zë nënkupton shpenzimet e rrugës për pjesëmarrje në trajnime)

421- Regjistrimi i automjeteve motorike.....6.470

(Ky zë nënkupton regjistrimin e automjeteve motorike)

423 – Materiale dhe inventar i imët .....108.817

(Ky zë nënkupton materiale zyre për nevoja e institucionit, produkte ushqimore dhe mjete higjienike të realizuara nëpërmjet prokurimit publik dhe materiale për riparime të ndryshme: doreza, llamba, silikon, bojë smalt, vida, gozhdë, varëse....)



424 – Riparime dhe mirëmbajtje operative ..... 61.389

(Ky zë nënkupton dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim të rregullt të objektit, mirëmbajtje mujore të platformës për persona me nevoja të posaçme dhe mirëmbajtje të rregullt të sistemit zjarrfikës, mirëmbajtja e aparateve MKZ)

425 Shërbime kontraktuese ..... 405.999

(Ky zë nënkupton sigurimin e pronave të paluajtshme, sigurimin e tërë objektit, siguracionin e automjetit zyrtar dhe sigurimin e të punësuarve, shërbime juridike dhe honorarë për personat e angazhuar për mirëmbajtjen e seksioneve)

426 – Shpenzime të tjera operative ..... 109.216

(Ky zë nënkupton shpalljen e thirrjeve për prokurime publike, seminare, kamata për paga, pagesa për llogarinë përfundimtare)

464 – Transferta të ndryshme ..... 452.429

(Ky zë nënkupton pagesa për numrat CIP nga Biblioteka Universitare për libra, katalogë të botuar nga QFK - Karposh dhe honorarë për personat e angazhuar për nevojat e qendrës)

**RAPORT FINANCIAR**  
**për periudhën 01.01 - 31.12.2022**  
**për llogarinë buxhetore 7850109628-603-18**  
**të IP “Qendra Kulturore për Fëmijë” – Karposh, Shkup**

Të ardhura të realizuara nga Qyteti i Shkupit sipas të gjitha bazave

741111- Transferata nga nivele të tjera të pushtetit ..... 10.385.617

Arsyetimi i zërit:

(Ky zë nënkupton mjete të marra në mënyrë të dedikuar nga Qyteti i Shkupit për paga dhe kompensime për tre të punësuar, mjete për realizimin e programit të miratuar për vitin 2022, kompensim i dedikuar për anëtarët e Këshillit drejtues dhe mbikëqyrës për vitin 2022 dhe rikonstrukcionin e objektit afarist).

Shpenzime gjithsej:

Sipas grupeve:

401- Paga neto dhe kompensime ..... 1.110.475

402 – Kontribute për sigurim social ..... 430.621

425 – Shërbime kontraktuese ..... 434.474

(Kompensim i dedikuar për anëtarët e Këshillit drejtues dhe mbikëqyrës për vitin 2022).

464 – Shpenzime të tjera operative ..... 4.905.517

(Realizimi i programit të miratuar për vitin 2022)

481 – Rikonstrukcioni i objekteve afariste ..... 3.504.530

(Përpilimi i projektit themelor dhe rikonstrukcion i objektit afarist të realizuara nëpërmjet prokurimit publik)

U.D. Drejtor  
Dr. Biljana Lalçevska Serafimovska

